



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR APLIKIM

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 50, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” kërkon të rekrutojë një ekspertit të jashtëm për asistencë në koordinimit e fushatës së informimit të publikut për procesin e digjitalizimit:

TERMAT E REFERENCES

Objektivi i punës:

Koordinimin i punës për fushatën e informimit të publikut për procesin e digjitalizimit.

Detyrat kryesore:

- Përcaktimin e linjës editoriale për AMA-n;
- Instruktimi i punonjësve për mënyrën e prezantimit përpara kamerës;
- Ndërlidhja ndërmjet redaktorëve të emisionit dhe përfaqësuesve të AMA-s;
- Përcaktimi i tematikave që do të diskutohen në çdo emision;
- Koordinimi me televizionet për oraret, regjistrimet, kohën e transmetimit të emisioneve/intervistave;
- Përcaktimi i Drejtorive (përfaqësuesve) që do të marrin pjesë në emisione/intervista;
- Hartimi i një raportimi në çdo fund muaji mbi punën e kryer, emisionet/intervistat e realizuara, përfaqësimin e AMA-s.

Autoriteti do t’i sigurojë ekspertit të gjithë informacionin e nevojshme mbi procesin e digjitalizimit për t’u njohur, me qëllim përmbushjen e detyrave të mësipërme.

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojë diplomë në gazetari/komunikim/regjizurë;
- Të ketë minimalisht pesë vite eksperiencë pune;
- Të ketë dhënë kontributin e tij/saj me shkrime/ botime/ filmime në lidhje me profesionin;

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore për të ushtruar detyrën;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;

Kandidatët duhet të depozitojnë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentet si më poshtë vijon:

1. Jetëshkrimin;
2. Fotokopja e diplomës;
3. Lista e notave;
4. Dy referenca nga punëdhënësi;
5. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Fotokopje të kartës së identitetit;
8. Fotokopje të librezës së punës ku të vërtetohet eksperiencia në punë;
9. Çdo dokument që vërteton trajnime, certifikata për pjesëmarrje në kurse të ndryshme, kualifikime pas shkollore etj.

Periudha e zbatimit të shërbimit:

Periudha e zbatimit të shërbimit propozohet të jetë nga data 1 Shtator 2016 deri në përfundim të fushatës së informimit të publikut.

Shpërblimi:

Shpërblimi do të jetë në masën e pagës së një specialist në kategorinë III-b dhe do të kryehet pasi të jetë dorëzuar raportimi në fund të çdo muaji për kryerjen e shërbimit për të cilin do të kontraktohet.

Produktet që do të dorëzohen:

Hartimi i një raportimi në çdo fund muaji mbi punën e kryer, emisionet/intervistat e realizuara, përfaqësimin e AMA-s. Raportimi do të duhet të dorëzohet në protokollin e AMA-s.

APLIKIMET MBYLLEN ME DATE 31 GUSHT 2016